



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 21.9.2023

Nr: 784

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**EMËRIMIN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR
NR. 11, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24
SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 9, pika 8, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së administrimit Zgjedhor”, si dhe propozimit të KZAZ-së nr. 11, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të nenit 9, pika 8, të vendimit nr. 5 datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonë së Administrimit Zgjedhor”, emëron kryetarët dhe zëvendëskryetarët e KZAZ-ve sipas propozimit të KZAZ-ve.

Me vendimin nr. 778, datë 19.09.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka liruar nga detyra zv/kryetarin e KZAZ-së nr. 11 dhe e ka emëruar anëtar të KZAZ.

Referuar vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si më lart përmendur, KZAZ-ja nr. 11 në kushtet e vakancës së zv/kryetarit në KZAZ, ka propozuar me vendimin nr. 07 datë 19.09.2023 zv/kryetarin e KZAZ-së z.Halim Murat Gjana.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, e gjen atë në përputhje me kërkesat e nenit 29, pika 2, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 9, pika 8, të Vendimit nr. 5 datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”,

V E N D O S:

1. Emërimin në detyrë të zëvendëskryetarit të KZAZ-së nr. 11, z. Halim Murat Gjana, Bashkia Kukës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI